

Sinjalizime

# Gruaja e denoncoi për dhunë, Policia i gjen kallashnikov në shtëpi – 65-vjeçari procedohet penalisht në Deçan



Sinjali.com

22 Korrik 2026 09:18



**Një denoncim për dhunë në familje ka çuar në zbulimin e një arme automatike në një shtëpi në fshatin Baballoq të Deçanit, raporton Sinjali.**

Sinjali mëson ekskluzivisht se i dyshuari është Xh. J. rreth 65-vjeç ndërsa viktimë bashkëshortja e tij, T. R. rreth 48 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja është raportuar më 21 korrik, rreth orës 08:00, kur Policia ka ndërhyrë pas një njoftimi për dhunë në familje.

Viktima është shoqëruar në stacion policor, ku ka deklaruar se për një kohë të gjatë ka qenë viktimë e dhunës fizike dhe psikike nga bashkëshorti i saj. Ajo ka pohuar se edhe ditën kritike ishte goditur në krahun e majtë, në stomak dhe në fytyrë, me çelësat e veturës dhe me një shkop druri.

Sipas deklarimit të saj, bashkëshorti posedonte edhe një armë zjarri, me të cilën e frikësonte dhe e kanoste.

Pas raportimit, Policia ka shoqëruar të dyshuarin në stacion, ku ai ka mohuar akuzat për dhunë ndaj bashkëshortes.

Me urdhër të Prokurorit është kryer bastisje në shtëpinë e tij, ku policia ka gjetur dhe sekuestruar një pushkë automatike AK-47 dhe një karikator.

Me vendim të Prokurorit të Shtetit, ndaj Xh.J. është iniciuar procedurë për veprat penale *“Dhunë në familje”* dhe *“Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”*.

Pas intervistimit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për rastin vazhdojnë.

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Armë

bashkëshorten

Deçan

Dhunë

Policia

## Të tjera:




**Policia e konfirmon për Sinjalin se polici 35-vjeçar dyshohet se ka kryer vetëvrasje**

**Siguri**



**Plagosje, përleshje dhe të shtëna me armë zjarri, policia arreston dy persona në Pejë**

**Siguri**



**Policia kërkon ndihmë nga qytetarët për kapjen e të dyshuarit për vjedhje**

**Siguri**



**Ekskluzive | Ky është i dyshuari që u paraqit pas dy javësh në arrati – Policia i kishte gjetur ...**

**Sinjalizime**




**Ekskluzive | Aksion i madh kundër evazionit fiskal në Prizren e Suharekë – zbulohen...**

**Sinjalizime**




**Ekskluzive | Të shtëna me kallashnikov në aheng familjar në Prizren – dy persona në prang...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Ky është zyrtari i arrestuar për lejimin e importit të kimikateve të ndaluara...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Policia ia konfiskoi veturën, 35-vjeçari kërcënon dhe fyen dy zyrtarë policor...**

**Sinjalizime**

## Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



### Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

### Aktualitet

Politikë  
Drejtimi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

### Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

### Ekonomi

Prodhome Vendore  
Financa  
Biznes

### Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftake  
Sporte të tjera

### Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

### OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

### Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

### Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

### Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

### Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera

